

**RAPORTI PARAPRAK**  
**I**  
**VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS**  
**TE AKTIVITETIT:**  
**“Ndertim linje te re ujesjellesi me gjatesi 19.912km dhe**  
**kanalizimesh me gjatesi 6.046 km, Pogradec”**

**Subjekti:** “Ujesjelles Kanalizime Pogradec” Sh.A



**Vendndodhja:** Pogradec

**Pergatiti materialin :** “Eko- Studio- Projekt” sh.p.k

**Tirane, 2015**



# **PERMBAJTJA**

-  Hyrje
-  Baza ligjore

## **1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT**

- Qellimi dhe karakteristikat fizike te projektit
- Vendndodhja e aktivitetit
- Pershkrimi I projektit

## **2. PERSHKRIMI I TEKNOLOGJISE**

## **3. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI**

## **4. VLERESIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS**

## **5. MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE**

## **6. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**

## **HYRJE**

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre te pashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qe eshte bere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere , perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme. Ndaj eshte e nevojshme qe shoqeria te ndergjegjesohet per ta mbajtur sa me paster mjedisin ku jetojme duke marre masat e duhura per trajtimin e mbetjeve si dhe emetimin e gazeve te demshem ne atmosfere qe gjenerohen nga zhvillimi i aktiviteteve te ndryshme.

Materiali qe paraqitet trajton ndikimet ne mjedisin fizik dhe human te aktivitetit:

### **“Ndertim linje te re ujesjellesi me gjatesi 19.912km dhe kanalizimesh me gjatesi 6.046 km, Pogradec”**

Raporti i *Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis* siguron qe ndikime mjedisore te rendesishme jane vleresuar dhe marre ne konsiderate ne menyre te kenaqshme ne planifikim, projektim dhe zbatim te projektit.

**Kur parametrat mjedisore nuk jane konform ligjeve, normave dhe rregullave te mjedisit, rrjedhimisht kemi ndotje te tij dhe prishje te ekuilibrave natyror.**

Nxitja e zbatimit te ketyre normave kerkon nje perkujdesje nga ana e organeve legislative dhe vendimmarrese, ne menyre qe te rritet interesi si dhe detyrimi per ruajtjen e ekuilibrave natyror.

Ne kete raport *Vleresimi Ndikimi ne Mjedis* eshte trajtuar aktiviteti:

### **“Ndertim linje te re ujesjellesi me gjatesi 19.912km dhe kanalizimesh me gjatesi 6.046 km, Pogradec”**

## **BAZA LIGJORE**

Relacioni u përgatit ne zbatim te akteve ligjore dhe nenligjore Mjedisore :

- *Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »*
- *Urdhri e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedis te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »*
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis »*
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’*
- *VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mejdisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja ».*

### **1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT**

#### ➤ **Profili i propozuesit**

Subjekti **”UJESJELLES - KANALIZIME” SH.A** eshte rregjistruar prane QKR me numer NIPT-ti **J64103615J** . Vendi i ushtrimit te aktivitetit eshte ne **Pogradec**.

Me përgatitjen e dokumentacionit perkates subjekti kerkon te pajiset me Leje Mjedisore te Tipit B sipas *VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mejdisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja. »*

## ➤ Vendndodhja

Subjekti "UJESJELLES - KANALIZIME" SH.A eshte rregjistruar prane QKR me numer NIPT-ti **J64103615J** . Vendi i ushtrimit te aktivitetit eshte ne **Pogradec**.

## 2- PERSHKRIMI I TEKNOLOGJISE

Te dhena mbi objektin e ndertimit:

- Linja totale e ujesjellesit – 19.912 km( Geshtenjas lart- 3.241km dhe geshtenjas poshte- 11.164 km)
- Linja totale e kanalizimeve- 6.046 km( Kanalizime Bucimas- 4.858km dhe linje presioni per tek impianti- 1.188km)

### **3. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI**

- ***Pozita gjeografike***

Pogradeci ndodhet në juglindje të Republikës shqiptare, është kryeqendra e rrethit të Pogradecit dhe bënë pjesë ne qarkun e Korçës. Qyteti ka një sipërfaqe prej 13 km<sup>2</sup> dhe ndodhet në bregun e liqenit të Ohrit. Pogradeci shtrihet 700 metra mbi nivelin e detit në një luginë, e cila rrethohet nga malet në perëndim dhe nga kodra të ulta në jug dhe në lindje. Pogradeci ka një popullsi prej rreth 38,000 banorë dhe një dendësi të popullsisë prej 2,962 banorë për km<sup>2</sup>.



- ***Klima***

Rajoni i Pogradecit nga pikepamja klimaterike ben pjese ne brezin subtropikal me lageshtire. Ne kete breze nje vend te vecante ze zona mesdhetare subtropikale e Europes jugore , ku futet dhe gadishulli Ballkanik. Ne lindje te Shqiperise verehen ndryshime te konsiderueshme klimaterike te cilat shprehen me kalimin gradual ne zonen e klimes mesatare-kontinentale te Europe Qendrore. Persa i perket rrezatimit diellor ai eshte me i larte ne muajt Qeshor-Korrik-Gusht ku maksimumi arrihet ne muajin korrik, kurse rrezatimi me i ulet ne muajin Nentor-Dhjetor-Janar-Shkurt, minimumi arrihet ne muajin janar. Në Pogradec mbizotëron një [klimë](#) mesdhetare me rreshje dimërore dhe temperatura mesatare vjetore +22° Celsius.

Rreshjet analiza e regjimit te rreshjeve lidhet ngushte me veprimtarine ciklonike dhe anticiklonike, elemente te tjere te rëndesishem ne shperberjen e rreshjeve jane kushtet fiziko-gjeografike, vecorit e relievit, bimeia etj..Muajt me sasi me te madhe te reshjeve

jane nentori dhe dhjetori. Sasia vjetore e reshjeve lekundet ndermjet 650-750m/m, numri i diteve me reshje lekundet 85-95 dite ne vit. Lartesia maksimale e debores arrin 31-50cm. Minimumet absolute lekunden -10 deri ne -12°C. Drejtimi i eres ne kete rajon karakterizohet nga mbizoterimi i drejtimit veri-jug.

- ***Liqeni i Ohrit***

Eshte nja nga liqenet me origjinale te Ballkanit dhe te Europes si nga origjina edhe nga forma e gropes se tij grabenore, ashtu edhe per nga regjimi hidrologjik edhe nga fauna. Formimi i tij eshte ber ne te njejten kohe me grabenet e tjera te pjeses juglindore te vendit tone. Por ne ndryshim nga ato grabeni i Ohrit eshte ripertitur me nje amplitude me te madhe. Ne fillim liqeni ka pasur permasa me te medha se keto te sotmet. Ai ka qen i bashkuar me liqene te tjera qe mbulonin pjesen juglindore te vendit tone. Por sipërfaqja e tij ka ardhur vazhdimisht duke u zvogeluar si rrjedhim i erozionit regresiv te Drinit te Zi, i cili ka zbrapsur gradualisht ujin e liqenit deri ne nivelin e sotem. Liqeni i Ohrit eshte liqen tektoniko-karstik. sipërfaqja e liqenit eshte 362.6 km<sup>2</sup> prej te cilave 111.4 km<sup>2</sup> jane brenda kufirit tone, shtrirja nga veriu ne jug eshte 30.4 km kurse gjeresia 14.5 km, ai eshte nje liqen i thelle ku thellesia mesatare eshte 138 m ndersa maksimalja eshte 295 m.

Ne liqenin e ohrit shkarkohen ujerat e teperta te liqenit te prespes dhe te masivit karstik te Malit te Thate. Ky shkarkim kryhet nepermjet nje numri te madh burimesh nentokesore. Perberja kimike e ujerave te liqenit dallohen per permbajtjen e ulet te kriprave te tretura ne uje dhe vecanerisht te fosfateve dhe te nitrateve. Mineralizmi lekundet 200-250mg/l. Masen kryesore te mineralizimit e perbejne bikarbonatet e kalciumit dhe te magneziumit.

- ***Bimesia***

Bimësia përbehet kryesisht nga dushqet, mjaft te dëmtuara, nga shkurret mesdhetare kryesisht gjetherenese, nga pyjet e ahut e te halorëve dhe nga kullotat alpine ne lartësitë e maleve. Rajoni Juglindor ka pozite dhe kushte shume te përshtashme natyrore për zhvillimin e tij ekonomik : pasuri te shumta natyrore, relief te larmishëm, ne te cilin dallohen sidomos fushëgropat, gropat dhe luginat me toka te shumta për bujqësinë ; klime te përshtatshme për drithëra, panxharsheqeri, zarzavate, foragjere, molle, kumbulla etj.

- ***Fauna***

Ne kete rajon ka patur disa lloje kafshesh si ariu, ujku, derri, dhelpra, lepuri, kunadhja, ketri. Nga këto në rrezik zhdukje janë ariu, lepuri, kunadhja, baldosa, macja e egër dhe ketri. Llojet e zogjve kanë qenë dhe janë në një numër të konsiderueshëm, ku përmendim: shqiponjën, skifterin, thëllëzën, bilbilin, harabelin, qukapikun, laraskën, korbin, gallofin, lakuriqin e natës, kukuvajkën, bufin, pulëbardhën, shatoren, shtepkën, guzën, mëllenjën e zezë, mëllenjën e bardhë, mjelmat, pëllumbin i egër.

Nga këto në rrezik zhdukje për shkak të gjuetisë pa kriter, janë thëllëza, shatoret, shtepka dhe mjelma. Ndërsa kafshët ujore që popullojnë ujerat e liqenit jane lloje te ndryshem peshqeve te vecojme koranin, përmendim vedrën (lundërza) e ujit etj.

- ***Trashëgimia arkitekturale dhe historike***

Zona ku eshte parashikuar zbatimi i projektit, nuk përfshin objekte të veçanta arkitekturale dhe historike. Kjo zone ndodhet larg zonave arkeologjike per te cilat eshte i njohur ky qytet si amfiteatri apo kalaja bizantine.

- ***Ekonomia***

Natyrisht, për pjesën më të madhe të popullsisë së rajonit , e cila banon në zonat rurale, vlerësimi i tokës bujqësore, rritja e efikasitetit të saj nëpërmjet harmonizimit të nismës private të fermerëve me teknologjinë intensive bujqësore dhe partneritetit me agrobiznesin për komercializimin e produkteve cilësore natyrore, përbëjnë instrumentin më efikas për mirëqënien e asaj popullsie.

Industria ushqimore perpunon produktet bujqesore dhe blegtorale. Gjithashtu industria e drurit eshte e lidhur me shfrytezimin e pyjeve si dhe me fabrikat dhe punishtet e perpunimit te lendes se drurit ne Bilisht. Oferta e pasur natyrore , pozita shume e pershtatshme gjeografike, traditat e pasura , niveli i mire kulturor i popullsisë krijojnë kushte per zhvillimin e bujqesise, industrise , artizanatit dhe turizmit.



### **3.1 VLERESIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS**

Çdo aktivitet që zhvillohet shoqërohet me pasoja dhe ndikime në mjedis, që janë pjesë e atij kompromisi që shoqëria jone ka zgjedhur për tu zhvilluar. Megjithatë e rëndësishme është që të kuptohet natyra e këtyre proceseve, forma e shfaqjes së tyre dhe me analitikisht ndikimet e çdo operacioni të kryer.

- **Ndikimet në toke**

Ndikimet kryesore në toke do të jenë gjatë fazës së hapjes së kanaleve për vendosjen e tubacioneve të furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve, por drejtues të shoqërisë do të monitorojnë në mënyrë periodike këtë proces.

- **Ndikimet në cilësinë e ajrit**

Përsa i përket shkarkimeve në ajër nga zhvillimi i aktivitetit nuk emetohen gaze të demshme në atmosferë për mjedisin apo banorët e zonës përreth. Referuar natyrës së procesit nuk kemi sasi gazesh të shkarkuar në atmosferë, por vetëm pluhur gjatë hapjes së kanaleve në rast të kohës së thatë dhe me erë. Gazet prej mjeteve të punës janë në intervale kohore të shkurtra, brenda normave të lejuara pa ndonjë ndikim negativ në mjedisin përreth.

- **Ndikimi në ujë**

Nuk do të ketë ndikime negative në ujë.

- **Ndikimet nga zhurmat**

Zhurmat shkaktohen nga mjetet e punës për ndërtimin e ujesjellesit. Këto zhurma janë brenda normave të lejuara për mjedisë pune 8 orë, megjithatë shoqëria ka pajisur punetoret me mjete mbrojtëse ndaj saj.

#### **4. MASAT PER ELEMINIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE**

Kërkesat mjedisore që synojnë mbrojtjen e shëndetit e të mjedisit, përfshijnë specifikimin e kushteve, normave e standarteve të detyrueshme për mbrojtjen e pastërtisë së ajrit urban, të ujërave sipërfaqësore e nëntokësore, të cilësisë e vlerave të tokës, të territoreve urbane, rrugëve, trotuareve, zonave të gjelbëruara. Drejtues të subjektit i cili do të vihet në shfrytëzim, do të marrin në konsideratë të gjitha masat lehtësuese zbutese për ndikimet në mjedis.

##### ○ **Mbrojtja nga aksidentet dhe kushtet në punë**

##### ➤ **Detyrat e firmes së ndërtimit dhe e subjektit që do të zhvillojë aktivitetin:**

- Do të punesohen punonjës që e kanë mbushur moshën për punë dhe specialist të profesioneve që kerkohen.
- Do të punesohen punonjës që kanë eksperience të gjata në profesion.
- Punonjësit para fillimit të punës dhe gjatë saj në mënyrë periodike do të instruktohen për rreziqet në punë dhe masat e menyrat për parandalimin e tyre.
- Punonjësit do të pajisjen me mjete mbrojtëse si maska kundër pluhurave.
- Do të instruktohen punonjësit në mënyrë periodike.

##### ➤ **Detyrat e punonjësve:**

- Te mos përdore pije alkoolike para fillimit të punës dhe gjatë kohës së punës.
- Te kontrollojë gjendjen teknike të pajisjeve në përdorim para fillimit të punës dhe pasi konstatojë gjendjen e rregullt të tyre fillon punën.
- Kur konstatojë defekt dhe nuk është në gjendje ta eliminojë ndalon punën dhe ve në dijeni përgjegjësin me të afërt.
- Te përdore mjetet individuale të mbrojtjes gjatë punës.

##### ○ **Vlerësimi i efektivitetit të masave zbutese**

Realizimi i objektivave dhe treguesve të pritshëm të parashikuar në projekt do të varet nga respektimi i të gjithë treguesve të përcaktuar. Kontrolli, monitorimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve të punës do të çojnë përfundimisht në përfundimin e pamjeve të parashikuara në projekt, me sipërfaqe të pastra, të sistemuara e të gjelbëruara.

Për zbatimin e projektit del i nevojshem monitorimi dhe zbatimi i masave zbutëse. Kjo vjen si rezultat i pastërtisë teknologjike të aktivitetit.

Aktiviteti i objektit dhe lidhja e tij me rrugen nacionale nuk prek zonat arkitektonike, turistike, historike, rezervat kombetare natyrore, park kombetar, zone me interes shkencor, zone me bukuri te rralle natyrore, park rajonal e rural, zone ujore te mbrojtur, ndertime me vlere, monamente lashtesie, historike etj, sepse ne afersi te tije nuk ka zona te tilla te mbrojtura me status te vecante. Realizimi i objektivave dhe treguesve te pritshem te parashikuar ne projekt do te varet nga respektimi i te gjithe treguesve te percaktuar.

Ky project do te kete ndikime positive sepse:

- Do te furnizoje me uje pa nderpreje te gjithe zonen ku do te ndertohet ky rrjet ujesjellesi.
- Do te largoje ujerat e ndotura urbane duke ruajtur nje mjedis te paster.
- Do te punesoje nje numer te konsiderueshem njerzish nga zona perreth .
- Ky aktivitet nuk do te shkaktoje ndotje te ajrit, tokes, ujit te pijshem dhe ujrave nentokesore, se nuk do te kete shkarkime te ketyre lendeve.

#### o **Programi i monitorimit te ndikimeve ne mjedis**

Monitorimi i mjedisit ka per qellim qe nepermjet matjeve sistematike, vezhgimit, dhe raportimit ta paraqese ndryshimin e gjendjes se treguesve mjedisore qe te perberesve te mjedisit. Ne pergatitjen e programit te monitorimit specialistet do te marrin ne konsiderate mundesine per te realizuar nje monitorim realist te elementeve me ndikim ne mjedis. Ne fazen e ndertimit, monitorimi do te jete i tipit inspektim dhe raportim rutine.

##### ▪ **Plani i Monitorimit te Mjedisit**

Plani perfshin inspektime dhe raportime rutine, te cilet do te realizohen ne bashkepunim te ngushte te investitorit me organet kompetente lokale, rajonale dhe qendrore.

##### ▪ **Monitorimi i mbetjeve te ngurta inerte**

Mbetjet e gjeneruara gjate zhvillimit te procesit depozitohen ne vende provizore te percaktuara nga drejtues te subjektit dhe me pas ne menyre periodike keto mbetje te ngurta largohen per ne vendgrumbullimin e percaktuar nga pushteti vendor ose riperdore per qellime te ndryshme nga drejtues te shoqerise.

## **5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**

### **KONKLUZIONE**

Me e rendesishme per tu theksuar ne perfundim te ketij raporti te ndikimit ne mjedis (VNM) eshte se ai do ti vije ne ndihme mbrojtjes se mjedisit.

- ✓ Per cdo ndryshim qe do te behet ne projektin e linjes ose ne ndryshimin e kapaciteteve do te shoqerohet me kerkese te re per licensim.
- ✓ Zbatimi i kriterëve te vendosura ne projekt garanton mbrojtjen e mjedisit.
- ✓ Administratoret e subjektit kane marre masa per trajnimin e personelit per nderhyrje te shpejta ne rast avarish gjate procesit te punes.
- ✓ Do te furnizojë me uje pa nderpreje te gjithë zonen ku do te ndertohet ky rrjet ujësjes.
- ✓ Do te largojë ujërat e ndotura urbane duke ruajtur një mjedis te pastër.
- ✓ Do te punesojë një numër te konsiderueshem njerzish nga zona perreth .
- ✓ Ky aktivitet nuk do te shkaktojë ndotje te ajrit, tokës, ujit te pijshem dhe ujrave nentokësore, se nuk do te ketë shkakime te këtyre lendeve.

### **REKOMANDIME**

- Te respektohen te gjitha rregullat e sigurimit teknik ne ambientet e punes si gjate zhvillimit te procesit teknologjik.
- Te kontrollohet ne menyre periodike gjendja teknike e mjeteve te punes te cilat do te punojne.
- Punonjesit para fillimit te punes dhe gjate saj ne menyre periodike te instruktohen per rreziqet ne pune dhe masat e menytrat per parandalimin e tyre.
- Te behet monitorimi periodik i emetimit te zhurmave, cilesise se ajrit dhe cilesise se zhurmave.
- Te ndertohen pika grumbullimi te mbetjeve urbane qe shkaktohen nga veprimtaria e njerezve dhe te sherbimit e te transportohen per ne vendgrumbullimin e mbetjeve te percaktuara nga pushteti lokal.